

**Emri i Lëndës : Njohuri rreth Kur'anit dhe përkthimit të tij**

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 113	B	1	2	0	0	2.00	5
<b>Lektori dhe orari i konsultimeve</b>			Selman Kuzu, PhD				
<b>Asistenti dhe orari i konsultimeve</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>			Albanian, Turkish				
<b>Niveli i lëndës</b>			Bachelor				
<b>Përshkrimi</b>			Lënda "Njohuri rreth Kur'anit dhe përkthimit të tij" është në formën e hyrjes në shkencat e Kur'anit, ndër të cilat në krye vjen historia e këtij libri hyjnor. Këtu do të bëhet fjalë për përkufizimin e gjerë të Kur'anit, formave të shpalljes hyjnore, historisë së tekstit të Kur'anit, që nga shkëputja prej Zotit, e deri tek forma e tij në ditët e sotme. Do të studiohen të gjitha etapat historike dhe shndërrimet fizike që ka pësuar libri përgjatë historisë, si dhe pjesët e tij përbërëse. Duke analizuar edhe një tekst shembull, përftohen njohuri edhe rreth përkthimit të tij, gjë e cila është themelore për çdpkënd, që nuk e ka arabishten gjuhën mëmë, apo që do ta shpjegojë Kur'anin në një gjuhë tjetër veç arabishtes. Kjo lëndë realizon parapërgatitjen e studentit për lëndën e shkencave të Kur'anit. Kështu ai do të jetë formuar me njohuritë hyrëse në këtë fushë dhe do ta ketë shumë më të lehtë drejtëkuptimin e brendisë së tekstit të këtij libri.				
<b>Objektivat</b>			Ka për qëllim që t'i paraqesë studentëve njohuri hyrëse rreth shkencave të Kur'anit, duke i pajisur ata me informacion relativisht të mjaftueshëm në çështjet e zbritjes dhe transmetimit të tekstit kur'anor. Kështu, synohet prezantimi i një portreti të mirëfilltë të Librit Hyjnor.				

**Programi i Lëndës**

Java	Tema
<b>1</b>	Përkufizimi klasik i Kur'anit Fisnik dhe komentimi i saj i gjerë.
<b>2</b>	Përkufizimi i Kur'anit në traditën profetike dhe komentimi i saj.
<b>3</b>	Vahji, përkufizimi dhe llojet e tij.
<b>4</b>	Etapat e udhëtimit të Kur'anit deri në zbritjen e tij tek Profeti (s.a.s).
<b>5</b>	Ruajtja e Kur'anit në jetën e Profetit (s.a.s).
<b>6</b>	Grumbullimi i Kur'anit gjatë periudhës së kalifit të parë Ebu Bekrit (r.a).
<b>7</b>	Termet ajet dhe sure, dhe veçoritë e tyre.
<b>8</b>	Provim Gjysmëfinal
<b>9</b>	Suret e ajetet mekase dhe ato medinase. Dallimet mes tyre dhe format e emërtimit të sureve.
<b>10</b>	Shumimi i Kur'anit në periudhën e kalifit të tretë Osmanit (r.a).
<b>11</b>	Shtatë shkronjat dhe shkenca e kiraeteve.
<b>12</b>	Historiku dhe zhvillimi i pikëzimit dhe vendosjes së harekeve në tekstin e Kur'anit. Ndalesat gjatë leximit të tekstit.
<b>13</b>	Termet e spikatur në shpjegimin dhe drejtëkuptimin e tekstit hyjnor: Tefsir, te'uil, përkthim dhe meal.
<b>14</b>	Përkthimi i krahasuar i sures Huxhurat - 1.
<b>15</b>	Përkthimi i krahasuar i sures Huxhurat - 2.
<b>16</b>	Provim Final
<b>Parakushtet</b>	

<b>Literatura</b>	• İsmail Karaçam, Kur'an Okumanın Faziletleri, Marmara Üniversitesi, İstanbul, 2012
<b>Referenca të tjera</b>	• Alican Dağdeviren, Kur'an Okuma Sanatı Tecvit, Yeni Akademi Yayınları, İstanbul 2006.
<b>Punë laborator</b>	
<b>Përdorimi i komp.</b>	
<b>Të tjera</b>	

### Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

<b>1</b>	Studentët do të pajisen me njohuri të përgjithshme rreth përkufizimit të Kur'anit nga disa këndvështrime.
<b>2</b>	Studentët do të pajisen me njohuri të detajuara rreth zbritjes dhe transmetimit deri në ditët e sotme të tekstit kur'anor.
<b>3</b>	Studentët do të pajisen me njohuri hyrëse rreth metodave të përkthimit të Kur'anit.

### Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	40
Kuize	1	10
Projekte	0	0
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
<b>Total</b>		<b>100</b>

### Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	21	21
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>125</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>5</b>
<b>ECTS</b>			<b>5</b>